



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

Roli i pyetjeve të mësimdhënësit në zhvillimin e të menduarit kritik te nxënësit e shkollës fillore

Autori:

Elma Šaljunović

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Naser Zabeli

Programi:

Mësimdhënia dhe kurrikula

Viti akademik: 2026

HYRJE

Pyetjet e mësimdhënësit janë një mjet thelbësor për zhvillimin e të menduarit kritik te nxënësit e shkollës fillore. Ato ndihmojnë në krijimin e një klime të hapur për diskutim, nxisin kureshtjen, zhvillojnë aftësitë analitike, të menduarit abstrakt dhe njëkohësisht përgatitin nxënësit për të qenë të aftë që të mendojnë në mënyrë kritike (Lorant, 2016). Roli i mësimdhënësit në këtë rast është që të hartojë dhe përdorë pyetje të mirë-strukturuara që i vendosin nxënësit në qendër të procesit të të nxënës dhe i nxisin ata të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur.

Pyetjet e hapura dhe të menduara mirë i motivojnë nxënësit të kërkojnë përgjigje, të eksplorojnë alternativa dhe të zhvillojnë aftësi për të analizuar situata të ndryshme. Kjo i bën ata më të aftë të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe të argumentuar (Fetahu & Zharki, 2022).

Pyetjet që kërkojnë analizë, krahasim, vlerësim dhe arsyetim i ndihmojnë nxënësit të shkojnë përtej memorizimit të informacionit, duke i shtyrë drejt të menduarit të thellë dhe kritik. Andaj kur nxënësit përballen me pyetje që kërkojnë të mbrojnë një qëndrim ose të japin arsye për një mendim, ata mësojnë të ndërtojnë argumente logjike dhe të analizojnë të dhënat në mënyrë kritike (Matheis & Mehmeti, 2024).

Këto pyetje duhet të integrohen në të gjitha lëndët, të lidhen me çështje të botës reale dhe të mbështeten nga një mjedis bashkëpunues në klasë. Ky hulumtim njëherazi hedh dritë mbi ndikimin që këto pyetje kanë tek nxënësit e shkollave fillore, kjo një moshë mjaft kritike për zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit. Ky hulumtimi është një burim i vlefshëm për të gjithë aktorët e përfshirë në procesin edukativo-arsimor dhe mund të cilësohet si ndihmesë në avancimin e cilësisë së arsimimit në edukimin fillor në Kosovë dhe më gjerë.

Ky punim master hulumton rolin e pyetjeve të mësimdhënësit në zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit e shkollës fillore. Ku theksi vendoset mbi rëndësinë praktike të mësimdhënies bashkëkohore që e pozicionon nxënësin në qendër të procesit të të nxënës. Punimi fillon mbi faktin e argumentuar nga hulumtimi të mëparshme se të menduarit kritik është një kompetencë thelbësore për përgatitjen e nxënësve për sfidat akademike dhe jetësore, dhe se pyetjet e strukturuara mirë përbëjnë një ndër mjetet më efektive për ta zhvilluar këtë. Në pjesën teorike trajtohen konceptet e shkollimit fillor, të nxënës si proces aktiv, mësimdhënies cilësore dhe zhvillimit të fëmijëve, si dhe përkufizime dhe qasje të ndryshme mbi të menduarit kritik. Gjithashtu potencohet fakti se dallimi mes pyetjeve të nivelit të ulët (kujtesë/memorizim) dhe atyre të nivelit të lartë (analizë, vlerësim, argumentim), duke mbrojtur atë që këto të fundit ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e mendimit kritik.

Metodologjia

Metodologjia e studimit është kualitative dhe përfshin intervista me 10 mësimdhënës dhe vëzhgimin e 10 orëve mësimore në klasat I–V. Sipas rezultateve shihet se pjesa dërmuese e mësimdhënësve përdorin pyetje të hapura dhe nxitëse, të cilat rrisin përfshirjen aktive të nxënësve, nxisin diskutime dhe forcojnë aftësitë analitike e argumentuese. Megjithatë, evidentohen edhe sfida si mungesa e kohës, ngarkesa kurrikulare dhe nevoja për përgatitje më të thelluar profesionale.

Punimi si hulumtim ofron të dhëna konstatuese që mbrojnë atë se përdorimi sistematik i pyetjeve të hapura dhe të orientuara drejt niveleve të larta kognitive është kyç për zhvillimin e të menduarit kritik dhe për përmirësimin e cilësisë së arsimit fillor në Kosovë.

Rezultatet kryesore

Rezultatet nga ky hulumtim potencojnë rolin që pyetjet e mësimdhënësve kanë mbi zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit e shkollës fillore.

Hulumtimi konkludon se pyetjet e menduara mirë, të hapura dhe stimuluese janë thelbësore për nxitjen e të menduarit të nivelit të lartë. Studimi ofron një kuptim të qartë dhe të argumentuar mbi mënyrën se si pyetjet e mësimdhënësit ndikojnë në zhvillimin e të menduarit kritik te nxënësit e shkollës fillore.

Diskutimi

Nga analizimi i intervistave të këtij punimi shihet gjithashtu se shumica e mësimdhënësve në mënyrë të vetëdijshme dhe të planifikuar në vazhdimësi përdorin pyetje të hapura me karakter analitik dhe reflektiv gjatë orëve në procesin mësimor të tyre. Njëjtë edhe studime të tjera empirike në Kosovë mbi programet e të menduarit kritik dhe praktikën bashkëkohore raportojnë rritje të angazhimit të nxënësve, aktiviteteve aktive/ndërvepruese dhe disa indikatorë të cilësisë së mësimdhënies, por edhe rezultate të përziera (p.sh., jo gjithmonë dallime të forta mes mjediseve “kritike” dhe “tradicionale”), gjë që e bën të domosdoshme një diskutim të nuancuar mbi zbatueshmërinë, kushtet sistematike dhe mënyrën e implementimit të “mendimi kritik” në klasë (Kadrija, Effects of Critical Thinking Implementation On Enhancing of Teaching Quality in 9-Yer Schools of Gjakova Region, 2020). Ngjashëm, (Kadrija & Gashi-Shatri, 2023) në

hulumtimin empirik pranë shkollave që aplikojnë programin e të menduarit kritik kundrejt atyre tradicionale, autorët raportojnë se, “në tërësi”, për disa aspekte didaktike që lidhen me përgatitjen për të nxënë të pavarur, nuk u gjetën dallime të mëdha mes dy mjediseve—duke sugjeruar se konteksti i përbashkët i punës dhe standardet e njëjta mund të zbehin diferencat. Në literaturën ndërkombëtare, meta-analiza nga (Redfield & Rousseau, 1981) dhe (Winne, 1979) mbi diskursin në klasë sugjerojnë se pyetjet e hapura mund të lidhen me përmirësime në arritje dhe në cilësinë e të menduarit, por evidenca nuk është monolite: rishikime të tjera kanë gjetur efekte të vogla ose jo të qëndrueshme dhe theksojnë se ndikimi varet nga mosha/kapaciteti i nxënësve, lënda, mënyra e monitorimit të ndërhyrjes, si dhe nga praktika shoqëruese.

Përfundimet dhe rekomandimet

Të dhënat e fituara nga ky punim ofron implikime praktike të rëndësishme për mësimdhënësit por edhe për instancat politikëbërëse të arsimit në nivel vendi.

Për mësimdhënësit shihet se ata duhet të inkurajuar dhe mbështetur që të planifikojnë e të integrojnë qëllimisht pyetje me përgjigje të hapura në të gjitha fazat e mësimin - jo vetëm gjatë reflektimit ose përfundimit, por edhe gjatë hyrjes dhe zhvillimit të mësimin. Kjo shihet se ndikon në procesin e zhvillimit të të menduarit kritik të nxënësve.

Gjithashtu, si implikim tjetër për mësimdhënësit është ofrimi i trajnimeve të mësimdhënësve në mënyrë specifike për inkuadrimin e pyetjeve dhe rolin që këto të fundit kanë në zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit. Trajnimet e tilla mund të përqendrohen në mënyrën e duhur të hartimit, renditjes si edhe përshtatjes së pyetjeve sipas nivelit të nxënësve (klasës por edhe dallimeve brenda të njëjtës klasë).

Një adresim i rëndësishëm është edhe ai strukturor. Shkollat dhe institucionet arsimore edukatore duhet që t’i adresojnë vështirësitë apo kufizimet që mësimdhënësit hasin në implementimin e pyetjeve në orët e tyre mësimore. Si faktorë limitues shihet: aspekti kohor, kurrikula voluminoze, të cilat rendojnë kohet që mësimdhënësit kanë për inkuadrimin më të madhe të pyetjeve të hapura, diskutimeve dhe argumentimeve në orën 45 minutëshe.

E gjithë kjo ka kuptim jo të plotë pa një ambient korrekt. Kjo do të thotë që mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis ku nxënësit ndihen të sigurt, të lirë, të mbështetur dhe të përfshirë për të dhënë input-in e tyre gjatë pyetjeve, diskutimeve dhe argumentimeve. Kështu kur këto kushte plotësohen, nxënësit ndihen të dëgjuar dhe mendimi i tyre i respektuar, që i bën ata të inkurajuar për të thënë atë që ata kanë për të thënë.

Fjalët kyçe: edukim, mësimdhënie, të menduarit kritik, nxënësit shkollimi fillor.

Extended Abstract**Title of the theis:**

The role of teachers' questions in developing critical thinking among primary school students

Author:

Elma Šaljunović

Supervisor:

Prof. Ass. Dr. Naser Zabeli

Study programme:

Teaching and Curriculum

Academic year:

2026

Introduction

Questions asked by teachers are an essential tool for developing critical thinking in primary school students. They help create an open climate for discussion, encourage curiosity, develop analytical skills and abstract thinking, and at the same time prepare students to think critically (Lorant, 2016). In this context, the role of the teacher is to design and use well-structured questions that place students at the center of the learning process and encourage them to think critically and independently.

Well-designed open-ended questions motivate students to seek answers, explore alternatives, and develop the ability to analyze different situations. This makes them more capable of thinking independently and argumentatively (Fetahu & Zharki, 2022).

Questions that require analysis, comparison, evaluation, and reasoning help students move beyond memorizing information, pushing them toward deeper and more critical thinking. Therefore, when students are faced with questions that require them to defend a position or provide reasons for an opinion, they learn to construct logical arguments and critically analyze information (Matheis & Mehmeti, 2024).

These questions should be integrated across all subjects, connected to real-world issues, and supported by a collaborative classroom environment. This research simultaneously sheds light on the impact that such questions have on primary school students, a particularly critical age for the development of critical thinking skills. This study represents a valuable resource for all actors involved in the educational process and may serve as a contribution to advancing the quality of primary education in Kosovo and beyond.

This master's thesis explores the role of teachers' questions in developing critical thinking among primary school students. The emphasis is placed on the practical importance of contemporary teaching, which positions the student at the center of the learning process. The paper begins with the argument, supported by previous research, that critical thinking is an essential competency for preparing students for academic and life challenges, and that well-structured questions are among the most effective tools for developing it. The theoretical section addresses the concepts of primary education, learning as an active process, quality teaching, and child development, as well as different definitions and approaches to critical thinking. It also emphasizes the distinction between lower-level questions (recall/memorization) and higher-level questions (analysis, evaluation, argumentation), arguing that the latter directly influence the development of critical thinking.

Methodology

The study methodology is qualitative and includes interviews with 10 teachers and observations of 10 lessons in grades I–V. According to the results, it is evident that the majority of teachers

use open-ended and stimulating questions, which increase students' active participation, encourage discussion, and strengthen analytical and argumentative skills. However, challenges were also identified, such as lack of time, curriculum overload, and the need for more in-depth professional preparation.

As a research study, this paper provides findings that support the claim that the systematic use of open-ended questions oriented toward higher cognitive levels is key to the development of critical thinking and to improving the quality of primary education in Kosovo.

Main Findings

The results of this research emphasize the role that teachers' questions play in the development of critical thinking among primary school students.

The study concludes that well-designed, open-ended, and stimulating questions are essential for fostering higher-order thinking. The research provides a clear and well-argued understanding of how teachers' questions influence the development of critical thinking among primary school students.

Discussion

The analysis of the interviews conducted in this study also shows that the majority of teachers consciously and consistently use open-ended questions with an analytical and reflective character during their lessons and throughout the teaching process. Similarly, other empirical studies in Kosovo regarding critical thinking programs and contemporary teaching practices report increased student engagement, active/interactive activities, and some indicators of teaching quality, but also mixed results (e.g., not always strong differences between “critical” and “traditional” learning environments), which makes a nuanced discussion on the applicability, systemic conditions, and implementation of “critical thinking” in the classroom necessary (Kadrija, *Effects of Critical Thinking Implementation on Enhancing the Quality of Teaching in 9-Year Schools of the Gjakova Region*, 2020).

Likewise, Kadrija and Gashi-Shatri (2023), in their empirical research conducted in schools applying critical thinking programs compared to traditional schools, report that “overall,” for certain didactic aspects related to preparation for independent learning, no major differences were found between the two environments—suggesting that the shared work context and the same standards may reduce these differences.

In the international literature, the meta-analysis by Redfield and Rousseau (1981) and Winne (1979) on classroom discourse suggests that open-ended questions may be associated with

improvements in achievement and in the quality of thinking. However, the evidence is not monolithic: other reviews have found small or inconsistent effects and emphasize that the impact depends on students' age and abilities, the subject area, the way the intervention is monitored, and the accompanying teaching practices.

Conclusions and Recommendations

The data obtained from this study provide important practical implications for teachers as well as for educational policymakers at the national level.

For teachers, the findings suggest that they should be encouraged and supported to intentionally plan and integrate open-ended questions into all phases of the lesson—not only during reflection or conclusion, but also during the introduction and development of the lesson. This has been shown to positively influence the development of students' critical thinking skills.

Another important implication for teachers is the provision of professional training specifically focused on the inclusion of questions and the role these questions play in developing students' critical thinking. Such training may focus on the proper design, sequencing, and adaptation of questions according to students' levels (grade level as well as differences within the same classroom).

An equally important issue is the structural dimension. Schools and educational institutions should address the difficulties and limitations teachers face in implementing questioning techniques during their lessons. Limiting factors include time constraints and overloaded curricula, which reduce the opportunities teachers have to incorporate more open-ended questions, discussions, and argumentation within a 45-minute lesson.

All of this, however, cannot be fully meaningful without an appropriate environment. This means that teachers should create a classroom atmosphere in which students feel safe, free, supported, and included in giving their input during questioning, discussions, and argumentation. When these conditions are met, students feel heard and their opinions respected, which encourages them to express their thoughts and ideas more openly.

Keywords: education, teaching, critical thinking, primary school students.

